



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË **DISTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA**

Adresa: "Tirana", pn GJAKOVË, KOSOVË
Tel & Fax: +381 (0) 390 328 329

Nr. i Biznesit: 811326471

www.ngrohtorja.org

Datë: 07.07.2023

Nr: 412

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 për Ndërmarrjet Publike (i publikuar në Gazetën Zyrtare me datë 30.05.2012), dhe Rregullores për Sistematizimin e vendeve të punës nr.155, si dhe Statutit të ndërmarrjes Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i N.P. "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A Gjakovë, në mbledhjen e mbajtur më datë 07.07.2023, mori vendim të shpallë këtë:

K O N K U R S

- **Pozita e punës:** Kryeshef/e Ekzekutiv/e të N.P "Ngrohtorja e Qytetit" SH.A Gjakovë
- **Kohëzgjatja e mandatit:** 3 (tre) vite, sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike.
- **Vendi i punës:** Gjakovë

Të përgjithshme:

Kandidati/ja për këtë vend pune duhet të jetë person me integritet, i cili/e cila i plotëson kushtet e kualifikimit dhe kriteret e pavarësisë, posedon përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e kërkuar, si dhe i plotëson kushtet tjera të kërkuara me dispozitat e ligjit për ndërmarrjet publike dhe aktet tjera pozitive relevante.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Kryeshefit Ekzekutiv (KE)

- organizon dhe udhëheqë me procesin e punës;
- organizon dhe udhëheqë afarizmin e, ndërmarrjes;
- përfaqëson para personave të tretë, ndërmarrjen;
- nënshkruan të gjitha kontratat e ndërmarrjes;
- kujdeset mbi realizimin e ligjshmërisë në punën e ndërmarrjes;
- propozon bazat e politikës afariste, planin dhe programin e punës, të cilat i miraton Bordi i Drejtorëve;
- vepron sipas qëndrimeve të dalura nga mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- ndërmerr masat e nevojshme për realizimin e politikës afariste, të planit dhe programit të punës;
- zbaton vendimet e Bordit të Drejtorëve që kanë të bëjnë me organizimin e procesit të punës; organizimin dhe udhëheqjen me afarizmin e ndërmarrjes, përfaqësimin e ndërmarrjes dhe kujdesin për zbatimin e ligjshmërisë në punë;
- propozon Plan Programin për organizimin e ndërmarrjes;
- propozon Bordit hapjen e konkursit për vende të lira të punës dhe shkarkimin e punëtorëve në raste të shkeljes së ligjeve dhe Rregullores;

- propozon në raste të veçanta edhe shkarkimin e Kryeshefit të Financave, Sekretarit dhe Zyrtarit të Brendshëm të Auditimit, në raste të moszbatimit të ligjit, rregullores dhe vendimeve të Bordit të Drejtorëve;
- vendos mbi sistemimin e punëtorëve në punët dhe detyrat e punës dhe detyra tjera të caktuara, sipas rregullores dhe organogramit mbi sistematizimin e vendeve të punës;
- përcjellë dhe kontrollon afarizmin në tërësi të departamenteve;
- paraqet raportin mbi rezultatet e afarizmit të ndërmarrjes sipas llogarive vjetore;
- vendos lidhur me përgjegjësinë e punëtorëve në shkallë të parë;
- propozon pezullimin për zbatimin e akteve dhe të vendimeve të cilat janë në kundërshtim me ligjin dhe aktet e përgjithshme të ndërmarrjes;
- formon komisione dhe grupe punuese të përkohshme me qëllim të kryerjes së punëve të caktuara;
- lejon udhëtimet zyrtare për punëtorët e ndërmarrjes dhe personave të tjerë që angazhohen për kryerjen e punëve për ndërmarrjen;
- kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me Aktin e Themelimit -Statutit dhe akte tjera të përgjithshme normative të ndërmarrjes;
- Për punën e vet i përgjigjet Bordit të Drejtorëve të ndërmarrjes, “Ngrohtorja e Qytetit ” Sh.A. Gjakovë.

Kompensimi i Kryeshefit Ekzekutiv:

Kompensimi dhe përfitimet e Kryeshefit Ekzekutiv do të përcaktohen në përputhje me deklaratën për politikën e kompensimit të ndërmarrjes konform Ligjit për Ndërmarrjet Publike.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë përgatitje superiore në fushat e: Makinerisë, Elektroteknikës, Ekonomisë, Juridik apo të tjera të ndërlidhura me aktivitetet, në të cilat vepron ndërmarrja;
- Të ketë së paku 5 vite përvojë në nivel të lartë të menaxhmentit në fushën e administrimit të biznesit, financave korporative, financa, menaxhim i thesarit, banka, konsulentë në biznes, industri ose nga një fushë tjetër e shkencës e cila ka të bëjë me veprimtarinë afariste të NP-së për së paku 5 vite, të ketë qenë kontabilist publik, jurist i kualifikuar, ose anëtar i kualifikuar i një profesioni tjetër i cili ndërlidhet ngusht me veprimtarinë afariste të NP-së;
- Të ketë shkathtësi organizative, drejtuese dhe aftësi të shkëlqyeshme të komunikimit;
- Shkathtësi të dëshmuara në punë me grupe dhe organizim të ndërmarrjes apo të ngjashme.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- CV – në;
- Aplikacioni (merret në ndërmarrje dhe plotësohet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit);
- Letër Motivimi;
- Dëshmi mbi kualifikimin profesional (nëse është diplomuar jashtë shtetit, të jetë e nostrifikuar diploma);
- Vërtetim mbi përvojën në punë si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe eksperiencës;
- Dokumenti që nuk jeni dënuar me vendim të formës së prerë (lëshuar nga Gjykata Themelore, jo më e vjetër se 6 muaj);
- E preferueshme njohja e gjuhës Angleze
- Deklaratë nën betim (që merret në ndërmarrje dhe plotësohet me rastin e dorëzimit të dokumentacionit).
- Kopjen e letërnjoftimit.

Konkursi mbetet i hapur 30 ditë kalendarike, përkatësisht prej datës **07.07.2023** deri më **05.08.2023 në ora 16:00/h**. Dokumentacioni i aplikantëve duhet të dorëzohet në arkivin e N.P “Ngrohtorja e Qytetit” SH.A. Gjakovë, çdo ditë pune prej orës **08:00/h – 16:00/h**, në zarf të mbyllur dhe të adresuar për Bordin e Drejtorëve të N.P “Ngrohtorja e Qytetit” SH.A Gjakovë, rr. “Behije Dashi”, pa nr. - Rezina.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.

Ndërmarrja Publike Komunale “Ngrohtorja e Qytetit” SH.A Gjakovë, ofron mundësi të barabarta punësimi për te gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës dhe inkurajon te gjithë femrat dhe meshkujt e te gjitha komuniteteve qe i plotësojnë kriteret e konkursit që të aplikojnë.

VËREJTJE: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të caktuar dhe të pakompletuara sipas kriterëve të konkursit do të rezultojnë me diskualifikimin e menjëhershëm nga Bordi i Drejtorëve.